



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec - Opština Orahovac

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Odeljenje za Geodeziju, Katastar i Imovinu



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



Komuna e Rahovecit

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 2427 Më 03.07.2026
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Datë/a	03.07.2026
Referencë/a	
Për/Za/To :	Z. Smajl Latifi - Kryetar i Komunës së Rahovecit
CC:	
Përmes/Prekp/Through:	
Nga/Od/From :	Besmire Bytyçi Drejtores e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Raporti gjashtë mujor i punës, janar-qershor 2026



RAPORTI GJASHTË MUJOR I PUNËS JANAR-QERSHOR 2026

Fillimi i vitit 2026, është karakterizuar me angazhim të shtuar në përmbushjen e detyrave të reja, si dhe në përfundimin e obligimeve të bartura nga viti paraprak.

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2026, aktivitetet tona janë zhvilluar në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga Kryetari i Komunës, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit dhe Planin e Punës për Vitin 2026.

Gjatë gjashtë mujtorit të parë të vitit 2026, aktivitetet kryesore të drejtorisë përfshijnë:

- Trajtimi i kërkesave nga qytetarët dhe gjeodetët privatë për ndarje dhe bashkim parcelash, regjistrim dhe çregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje të pronave, koordinata, modifikime dhe shërbime tjera sipas kërkesave;
- Lëshimin e certifikatave dhe kopjeve të planeve Kadastrale;
- Hartimi i listës së veçantë të pronave komunale;
- Përgatitjen e materialeve për dhënien në shfrytëzim të pronave publike për Kuvendin Komunal, sipas kërkesave të qytetraëve dhe grupeve të interesit;
- Gjeodetët kanë kryer matje sipas kërkesave të drejtorive përkatëse, për rrona komunale të cilat janë në interes të komunës;
- Në projektin e vektorizimit të disa Zonave Kadastrale, jemi në proces e sipër, këtë vit do të insertohen 17 Zona Kadastrale në sistemin KadastralMap.

- Kemi vlerësuar performancën e punonjësve për vitin paraprak;
- Në projektin e vektorizimit të disa Zonave Kadastrale, jemi në proces e sipër, për 18 ZK ky proces do të përfundojë në muajt e ardhshëm të vitit 2026;
- Kemi trajtuar lëndët me dyshim për uzurpim të pronës publike, në këtë periudhë janë marrë dy vendime për uzurpim, të dyja këto në ZK Xërxe;
- Dhe, kryerjen e detyrave tjera sipas detyrës zyrtare.

Para Kuvendit Komunal të Komunës, kemi paraqitur propozime të ndryshme për prona sipas ligjeve në fuqi, kemi shpallur prona me interes të përgjithshëm si dhe kemi marrë vendime për dhënie në shfrytëzim të pronave të komunës, në mënyrë që pronës publike ti rritet vlera dhe të shfrytëzohet.

Në kuadër të drejtorisë, operojmë me dy sektore:

- 1- Kadastër dhe Pronë
- 2- Gjeodezi

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2026, janë trajtuar kërkesa të shumta dhe lëshuar dokumente të ndryshme sipas kërkesave të palëve:

Emërtimi	Numri i lëndëve
Trashëgimi	156
Kontratë shitblerje	160
Kontratë dhurimi	81
Kontratë këmbimi	9
Kontratë qiramarrje	16
Kontratë ndarje fizike	7
Marrëveshje ndërmjetësimi	97
Aktgjykim	19
Hipoteka	16
Cregjistrimi i hipotekës	17
Historiate	12
Azhurnime	36
Barrë tatimore	5
Bashkim ID	26
Modifikim i ID	21
Ndarje e parcelave	66

Bashkim i parcelave	68
Bashkim dhe ndarje	6
Koordinata	150
Legalizim	7
Vendime për uzurpime	2
Servitut	1
Regj. i pjesës së ndërtesë	4
Certifikata të pronës	442
Kopje të planit	124
Kërkesë për social	59
Kërkesë për vërtetim që nuk posedon pronë	24
Kërkesë për dy çertifikata	61
Kërkesë për dy kopje të planit	17
Kërkesë për çertifikatë të pronës dhe kopje të planit	4
Modifikimi i attributeve të parcelës	1

Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, mbetet e përkushtuar që puna në interes të qytetarëve, bazuar në ligjet dhe rregulloret në fuqi, të jetë prioritet i përditshëm i drejtorisë, marrja e shërbimeve në kohë sa më të shpejtë dhe më lehta nga qytetarët do të vazhdojë të jetë fokus i punës sonë të përditshme .

Besmire Bytyçi

Drejtoreshë e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Komuna Rahovec

Mob: +383 (49) 199-099 / Ctx: +381 (0) 3820045311

E-mail adresa: besmire.bytyqi@rks-gov.net